

LIGJ
Nr.7425, datë 14.11.1990

PËR KONTABILITETIN

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshlit të Ministave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kontabiliteti organizohet dhe funksionon në mënyrë të detyrueshme në çdo ndërmarrje, institucion, njësi e repart ushtarak, kooperativë bujqësore e të artizanatit, organizatë shoqërore, si dhe në çdo person tjetër juridik ose fizik, që kryen veprimtari ekonomike në bazë të rregullave të caktuara me këtë ligj.

Neni 2

Kontabiliteti pasqyron dhe përcakton:

- a) Gjendjen dhe ndryshimet sasiore, cilësore e vlerore të vlerave materiale e monetare, vendndodhjen dhe përgjegjësitë për to.
- b) Vlerat materiale e monetare të përdorura për çdo veprimtari kryesore, ndihmëse ose dytësore.
- c) Produktet, punimet dhe shërbimet e përfitura nga çdo veprimtari.
- ç) Kostot efektive për çdo produkt, punim e shërbim ose grupim të tyre.
- d) Marrëdhëniet financiare me shtetin, me të tretët, me punonjësit, individët etj.
- dh) Të ardhurat e përgjithshme monetare nga shitja e produkteve, punimeve e shërbimeve prodhuese ose socialkulturore, si dhe rezultatin financiar.

Neni 3

Veprimet në kontabilitet bëhen duke u mbështetur në dokumente të caktuara dhe të miratuara sipas rregullave të veçanta.

Ndërmarrjet, institucionet, njësitë e repartet ushtarake, kooperativat bujqësore e të artizanatit, organizatat shoqërore, si dhe personat e tjerë juridikë ose fizikë që kryejnë veprimtari ekonomike i mbajnë dokumentet bazë e justifikuese në mënyrë të sistemuar e të rregull dhe i ruajnë sipas afateve të përcaktuar me dispozita të veçanta.

Neni 4

Regjistrimi i të dhënave të dokumenteve në kontabilitet bëhet në mënyrë kronologjike, sistematike, në kohën e caktuar, qartë e pa korrigjime, në tregues analitikë e përmbljedhës.

Ndryshimi i dyfishtë i gjendjes së vlerave materiale e monetare që sjellin veprimet ekonomike pasqyrohet në kontabilitet, duke respektuar lidhjet ndërmjet llogarive përkatëse.

Regjistrimet e pasakta në kontabilitet dhe paraqitja në dokumente kontabël e në bilancet financiare të vlerave materiale e monetare që nuk ekzistojnë fizikisht, përbëjnë shkelje të disiplinës së pasqyrit kontabël.

Neni 5

Kontabiliteti duhet të japë në çdo kohë informacion të saktë të veprimtarisë ekonomiko-financiare të organit ose njësisë përkatëse. Në fund të muajit, të tremujorit dhe të vitit bëhet përmbledhja e treguesve të veprimtarisë, duke nxjerrë bilancin kontabël dhe llogaridhënien përkatëse.

Rregullat e shqyrtimit e të miratimit të llogaridhënies caktohen nga Ministria e Financave.

KREU II ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Neni 6

Ministria e Financave ka udhëheqjen metodologjike të kontabilitetit të ndërmarrjeve, institucioneve, njësive, reparteve ushtarake, kooperativave bujqësore, kooperativave të artizanatit, organizatave shoqërore, si dhe çdo pesoni tjetër juridik ose fizik që kryen veprimtari ekonomike.

Ministria e financave cakton:

- a) Sistemet, metodat dhe format e përgjithshme të mbajtjes së kontabilitetit.
- b) Planin e përgjithshëm kontabël.
- c) Format dhe metodat e hartimit të llogaridhënies dhe mënyrat dhe afatet e paraqitjes së saj.
- ç) Format dhe afatet e paraqitjes së balanceve përmbledhëse nga organet qendrore.
- d) Mënyrën e dokumentimit të veprimeve ekonomike, format e dokumentacionit me përdorim të përgjithshëm dhe rregullat e përgjithshme për plotësimin e qarkullimit të dokumenteve.

Neni 7

Ministria e Financave ushtron kontroll të vazhdueshëm e të gjithanshëm për zbatimin e kontabilitetit nga ndërmarrjet, institucionet, njësitë e repartet ushtarake, kooperativat bujqësore e të artizanatit, organizatat shoqërore, si dhe nga personat e tjerë juridikë ose fizikë që kryejnë veprimtari ekonomike.

Ministria e Financave, kur vëren që mbajtja e kontabilitetit bëhet me të meta, të cilat nuk mund të ndreqen gjatë kontrollit, krahas masave që merr vetë, kërkon nga ministria ose institucioni tjetër qendror, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ose i rajonit dhe nga njësia e bashkuaqër ushtarake ku ushtron veprimtarinë organi i kontrolluar, që këta të marrin masa për ndreqjen e gjendjes. Kur nga ana e tyre nuk merren masa përkatëse, çështjen e raporton në Këshillin e Ministrave.

Neni 8

Për shqyrtimin e problemeve të kontabilitetit, pranë Ministrisë së Financave krijohet një këshill konsultativ. Përbërja e këshillit dhe rregullat e punës së tij miratohen nga Ministri i Financave.

Neni 9

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore drejtojnë kontabilitetin e degëve e të sektorëve që mbulojnë dhe caktojnë:

- a) Sistemet, metodat dhe format konkrete të mbajtjes së kontabilitetit.
- b) Planet kontabël të degëve dhe të sektorëve që mbulojnë.
- c) Mënyrat konkrete të hartimit të llogaridhënies dhe afatet e paraqitjes së saj.
- ç) Mënyrat e dokumentimit të veprimeve ekonomike, format e dokumentacionit financiar e kontabël specifik dhe rregullat e plotësimit e të qarkullimit të tyre.

Neni 10

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore shqyrtojnë cilësinë dhe ndjekin afatet e paraqitjes së llogaridhënies nga organet e degëve e të sektorëve që mbulojnë, hartojnë llogaridhënien përmbledhëse që e paraqesin në afatet e në organet që caktohen nga Ministria e Financave.

Neni 11

Ministritë dhe institucionet e tjera qendore ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm e të gjithanshëm dhe përgjigjen për zbatimin e kontabilitetit nga organet e degëve e të sektorëve që mbulojnë. Kur vërejnë të meta e mangësi, marrin vetë ose të së bashku me komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit soe të rajonit masat përkatëse për ndreqjen e tyre.

Kur komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve ose të rajoneve nuk marrin masa për ndreqjen e të metave e të mangësive, ministria ose institucioni tjetër qëndror njofton Këshillin e Ministrave.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore jo më rrallë se një herë në vit marrin në shqyrtim gjendjen e kontabilitetit në sistemin e tyre.

Neni 12

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e të rajoneve dhe njësitë e bashkuara ushtarake kanë për detytë të krijojnë kushtet dhe të ushtrojnë kontroll për mbajtjen e kontabilitetit në të gjitha ndërmarrjet, institucionet, njësitë e repartet ushtarake, kooperativat bujqësore e të artizanatit, organizatat shoqërore, si dhe në personat e tjerë juridikë e fizikë që kryejnë veprimtari ekonomike brenda rrethit dhe, kur vërejnë çrregullime, të meta e mangësi, të marrin masa dhe të njoftojnë, kur është rasti, organin më të lartë.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e të rajoneve dhe njësitë e bashkuara ushtarake të marrin çdo vit në analizë gjendjen e kontabilitetit në rreth dhe në njësitë e repartet ushtarake.

Neni 13

Drejtnesit e ndërmarrjeve, të institucioneve, të njësisve e të reparteve ushtarake, të kooperativave bujqësore, të artizanatit e të organizatave shoqërore janë të detyruar të marrin të gjitha masat e nevojshme organizative e teknike që kontabiliteti të kryejë rregullisht funksionet e tij, të nxjerrë të dhënat e duhura, të sakta e në kohë, për t'i shërbyer drejtimit me efektivitet të prodhimit dhe administrimit të pronës. Ata ndjekin rregulloren të brendshme për funksionimin e kontabilitetit në përputhje me rregullat e caktuara nga organet më të larta. Gjithashtu, përcaktojnë afatet dhe treguesit që sektorët e ndryshëm do t'i japin kontabilitetit për të përgatitur llogaridhënien e formën e saj, si dhe afatin e shqyrtimit sipas brigadave, sektorëve, reparteve, fabrikave e deri në shkallën e gjithë njësisë organizative.

Gjendja e kontabilitetit të merret në shqyrtim çdo tremujor së bashku me analizën e rezultateve ekonomiko-financiare.

KREU III ZBATIMI I KONTABILITETIT

Neni 14

Përgjegjësi i financës dhe i kontabilitetit ka për detyrë që veprimtarinë e pasqyrimit kontabilitetit ka për detyrë që veprimtarinë e pasqyrimit kontabël ta shtrijë mbi të gjithë veprimtarinë e organizmit ku vepron, për të siguruar administrim të plotë e të saktë të pronës e të prodhimit.

Neni 15

Përgjegjësi i financës dhe i kontabilitetit në ndërmarrje, institucion, njësi e repart ushtarak, kooperativë bujqësore, kooperativë artizanati edhe organizatë shoqërore përgjigjet për organizimin e kontabilitetit, për zbatimin e rregullave të caktuara për mbajtjen e tij, për paraqitjen në kohë të bilancit kontabël e të llogaridhënies financiare dhe për dokumentimin e plotë të veprimeve kur vëren se ato janë në kundërshtim me rregullat e dispozitat në fuqi; ushtron kontroll, informon dhe kërkon nxjerrjen

e përgjegjësish për cilindo që kryen e miraton veprime të paligjshme, të cilat dëmtojnë pronën.

Neni 16

Punonjësit e kontabilitetit varen e marrin udhëzime për mbajtjen e kontabilitetit nga përgjegjësi e tyre. Kur vërejnë ose dyshojnë për veprime të parregullta të dokumentacionit që përpunojnë, nuk u japin rrugë atyre, por njoftojnë përgjegjësin e kontabilitetit. Në bazë të këtij ligji, punonjësit e kontabilitetit përgjigjen për të gjitha veprimet që kryejnë vetë.

Neni 17

Qendrat e informatikës ekonomike në rrethe kanë për detyrë të ushtrojnë kontroll mbi rregullshmërinë e dokumentacionit që përpunojnë dhe, kur vërejnë ose dyshojnë për veprime të parregullta, nuk u japin rrugë atyre por njoftojnë, sipas rastit, drejtuesin e ndërmarrjes, të institucionit, të kooperativës bujqësore e të artizanatit, të organizatës shoqërore, si dhe organet e financës e të kontroll-revizionit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit. Në bazë të këtij ligji, punonjësit e qendrës së informatikës përgjigjen për të gjitha veprimet që kryejnë vetë.

Neni 18

Për moszbatimin e rregullave të caktuar në nenet 3, 4, 5 10, 13, 15 e 17 të këtij ligji, personat përgjegjës, kur shkelja nuk formon vetpër penale, dënohen për kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 500 lekë për çdo rast të vërejtur. Të drejtën e gjobës e kanë përgjegjësi i financës dhe i kontabilitetit në ndërmarrje, institucion, repart ushtarak e kooperativë, përgjegjësi i seksionit të financës e kontabilitetit në njësitë e bashkuara ushtarake, drejtori i drejtorisë ose kryetari i degës së financës dhe kontabilitetit në ministrinë e institucionet e tjera qendrore, si dhe drejtori i drejtorisë së kontabilitetit në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht, të përgjegjësi i financës dhe i kontabilitetit në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit dhe të njësisë së bashkuar ushtarake, te kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit te ministri ose drejtuesi i institucionit tjetër qendror dhe te Ministri i Financave, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 19

Ky ligj zbatohet edhe nga ndërmarrjet që zhvillojnë veprimtari ekonomike me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 20

Rregullat e hollësishme për zbatimin e këtij ligji caktohen nga Ministria e Financave.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Gazetën Zyrtare.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA